

Fshehtësia e informative

Informatait e marra qjatë cfarëdo aktiviteti bashkëpunues nuk do t'i zbulohen palëve të treta pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës nga e cila e kanë origjinën.

Pasojat e Ngacmimit Seksual:

Ngacmimi seksual rrezikon të keqësojë shumë shëndetin fizik e mendor të viktimit (humbe të vetëbesimit në vetyvet, dhimbje me origjinë psikosomatike, qregullime në të ushqyer, depresion etj.), ndërhyrje në kryerjen e punëve të individit ose krijon frikë dhe ambientin e punës e bën armiqësor dhe jo të sigurt. Ndër të tjera, mund të paraqesë pasoja të rënda për jetën sociale të viktimit dhe të familjes. Të gjitha këto ndikojnë edhe në procesin e punës, por edhe në krijimin e një ambienti të pasigurt dhe të frikshëm, prandaj nuk duhet të tolerohen në asnjë moment ngacmimet seksuale në vendin e punës. Institucionet publiko-private duhet te marinë masa ndëshkuese ndaj individëve te cilët shkaktojnë ngacminim seksual, duke l njoftuar autoritet përgjegjëse.




Udhëzues për raportimin e ngacmimit seksual.

Një shembull udhëzues për raportimin e ngacmimit seksual në vendin e punës.

- Raportoni incidentin me sa më shumë detaje të mundshme, duke përfshirë emrin e ngacmuesit/es, datën, kohen dhe veprimin e kryer dhe gjuhën e përdorur.
- Lajmëroni ngacmuesin/en se sjellja është e padëshirueshme dhe duhet të ndalet menjëherë. Përfshije këtë shkëmbim po ashtu në të dhënat tuaja.
- Nëse jeni në pozitë ku nuk doni të përballeni me personin, ose nëse personi në fjalë e injoron kërkesën e juaj, në këtë raste raportoni incidentin menjëherë tek mbikëqyrësi a po tek departamenti i burimeve njerëzore.
- Sigurohuni të informoheni tek doracaku i kompanisë juaj mbi politikën e ngacmimeve seksuale.
- Punëdhënësit kanë për detyrë për të siguruar një mjesid ku nuk tolerohet ngacmimi seksual dhe të mbrojnë sigurinë e individëve të cilët raportojnë incidente të ngacmimit seksual.
- Sigurohuni që të gjitha raportimet tek mbikëqyrësi ose në departamentin e burimeve njerëzore, të janë në shkrim dore. Sigurohuni të keni kopje të korrespondcave të juaja.
- Personat përgjegjës në kompaninë e juaj duhet të hetojë çështjen dhe të bëjnë të pamundurën për të ndaluar ngacminim seksual brenda një kohe të arsyeshme.
- Nëse ju mendoni se punëdhënësi juaj nuk e ka përbushur detyrën, ose është shume i ngadalte në përgjigje, kontaktoni një avokat kompetent. Sigurohuni që zëri juaj të dëgjohet dhe të drejtat e tuaja të respektohen.

Telefoni ose E-mail ose adresë



KËRKO MBROJTJE LIGJORE

Forma e Ngacmimit Seksual:

Për qëllimet e kësaj politike, termet në vijim kanë këto kuptime:

Ngacmimi Verbal - përfshinë, por nuk kufizohet në: komente, shaka, pyetje provokuese, komente të natyrës seksuale, ngucje, shprehje fyese, epitetë poshtëruuese, formulimë nënçmuese ose shpërdorime tjera verbale.

Ngacmimi Jo - verbal - përfshinë, por nuk kufizohet në: gjeste provokuese me lëvizje dhe prekje provokuese të pjesëve të ndryshme të trupit (të personit që provokon, të trupit të personit tjetër), mbajtja apo ngrënia e ushqimit në mënyrë provokuese.

Ngacmimi vizual- përfshinë, por nuk kufizohet në: ekspozim të reklamave, fotografive dhe shenjave pornografike, vizatime ose komente seksuale për veshjen, stolitë apo trupin e një individi.

Ngacmimi Psikologjik- përfshinë, por nuk kufizohet në: ftesa për intimitet fizik seksual. Presione për të pranuar ftesa shoqërore, për takime private dhe lidhje seksuale, pyetje, hetime apo diskutime për aktivitetet seksuale; Ngacmimi Fizik- i cili përfshinë: prekjen fizike, pickimin, putjhen, përkëndheljen dhe fërkimin e trupit të viktimitës.

Ngacmimi që ka shkaktuar ofendim konsiderohet edhe atëherë kur është i pa qëllimit. Në përgjithësi, ngacmimet seksuale paraqiten me akte që përsëriten në disa rrethana, po ashtu edhe një akt i vetëm mundet të konsiderohet si ngacmim seksual.

Në kuadër te ngacmimit seksual, personi/nja nuk lejohet të demonstrojë sjellje siç përkufizohen më poshtë:

- Komente për pamjen;
- Fjalë degraduese/ofenduese seksuale, për të përshkruar individin;
- Sjellje të tjera verbale dhe fizike të natyrës seksuale;
- Përdorim të materialeve pornografike;
- Vëmendje seksuale të imponuar;
- Komente grafike verbale për trupin e individit/individëve;
- Paraqitje të objekteve dhe vizatimeve të karakterit seksual në vendin e punës;
- Përdorimi i fjalëve të pamoralshme;
- Shtytje për ngacmimë seksuale;
- Kërkesë për seks si kushtëzim për pozitë më të lartë apo për përfitimet tjera;
- Presion i vazhdueshëm ose kërkesë për qëllime seksuale;
- Prekje e individit, si pickim, shtrëngim përqafim dhe fërkim të vazhdueshëm me trupin e punëtorit tjetër ose prekja e rrobave të tyre;
- Kërkim dhe këmbëngulje për qëllime seksuale, të përcjellura me kërcënime ose kushtëzime të dukshme lidhur me vendin e punës;
- Dërgimi i letrave duke përfshirë edhe letrat elektronike (E-mailave);
- Thirrjet telefonike ngacmuese shqetësuese duke përfshirë edhe mesazhet SMS nëpërmjet telefonave të dorës (telefona mobil);
- Kërkesë e tertiortë për qëllime seksuale;
- Prekje, përkëndhelje, pickime, ose fërkime të papërshtatshme ndaj trupit të dikujt tjetër;
- Gjuhë ose veprime vulgare apo imorale;

- Ekspozimi i pikturave, vizatimeve, fotografive ose objekteve që janë fyese ose nxitës nga natyra seksuale;
- Ngacmimi fyese seksuale gojore duke përfshirë fjalë, pyetje, ngacmimë, njollosje të dikujt ose sugjerime jo të drejtëpërdrejta;
- Shaka ose komente të papërshtatshme në lidhje me karakteristikat specifike gjinore;
- Shikimi, printimi, transmetimi dhe shpërndarja e materialeve fyese seksuale në një kompjuter të organizat të administratës publike;
- Ftesa të shoqëruara me premtimë të kompensimit, kërcënime apo presione të tjera;
- Paraqitja jo e drejtë e punës së dikujt apo vlerësimi jo i drejtë i punës së dikujt, mohimi i trajnimeve apo promovimit, mohimi i qasjes ndaj çdo mundësie tjetër akademike apo punësimi për shkak të refuzimit të favoreve të natyrës seksuale të definuar si më sipër;